VENDIM
Nr.159, datë 19.2.2008

PËR NGRITJEN E PËRFAQËSIMIT DIPLOMATIK NË NIVEL AMBASADORI TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS DHE HAPJEN E AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS NË PRISHTINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e përfaqësimit diplomatik në nivel ambasadori të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës dhe hapjen e ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës, në Prishtinë.
2. Shpenzimet për hapjen e përfaqësisë diplomatike të përballohen nga buxheti i viti 2008, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme.
3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha